



# BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.16

Janar 2005

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

## Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

**I. Mbledhje e Këshillit të  
Ministrave e datës 10.12.  
2004**

### **PROJEKTLIGJE**

*(Vendime për propozime projek-  
tligjesh)*

1. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar.
2. Për ratifikimin e Konventës "Për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike, në nivel lokal".
3. Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë, për ndihmë të ndërsjelltë juridike në çështjet civile.

### **VENDIME të Këshillit të Min- istrave data 10.12.2004**

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore" të ndryshuar.
2. Për një shtesë në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të

*(Vijon në faqen 2)*

## Nga Punimet e Kuvendit

**PËR MUAJIN DHJETOR  
2004**

Gjatë muajve nëntor-dhjetor 2004 Kuvendi, nëpërmjet komisioneve të tij dhe në seancë plenare, Kuvendi e ka përqëndruar punën në shqyrtimin e paketës fiskale dhe të projektbuxhetit të shtetit për vitin 2005.

Paketa fiskale përbëhet nga nëntë projektligje. Gjatë shqyrtimit të saj në komisionet e përhershme të Kuvendit kanë qenë të pranishëm Ministri dhe Zëvendësministrja e Financave, si dhe specialistët që kanë përgatitur projektligjet. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit organizoi disa takime me përfaqësues të grupeve të interesit si të Shoqatës së Bashkive, të Dhomës së Tregtisë, të Shoqatës së Tregtarëve, të Shoqatës së Ndërtuesve etj për të dëgjuar opinionet e tyre për secilin projektligj, të cilat më pas u bënë objekt debati i deputetëve.

Deputetët e maxhorancës u shprehën dakord në parim me projektligjet e paketës fiskale, duke vlerësuar si tipare kryesore

*(Vijon në faqen 5)*

**Në këtë numër  
do të lexoni:**

**1. Nga Mbledhjet e  
Këshillit të Ministrave  
faqe 1-4**

**2. Informacion mbi faqet  
e internetit të  
Institucioneve Qëndrore  
faqe 1**

**4. Nga punimet e  
Kuvendit për muajin  
dhjetor 2004  
faqe 1,5-15**

**5. Kalendari 3 javor i  
Kuvendit,  
31 janar - 17 shkurt 2005  
faqe 16-19**

## Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë  
[www.parlament.al](http://www.parlament.al)

Këshilli i Ministrave  
[www.keshilliministrave.al](http://www.keshilliministrave.al)

Presidenca  
[www.president.al](http://www.president.al)

Bashkia e Tiranës  
[www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

Ministria e Arsimit dhe e  
Shkencës  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Ministria e Punëve të Jashtme  
[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

Ministria e Shëndetësisë  
[www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Ministria e Rendit Publik  
[www.mpo.gov.al](http://www.mpo.gov.al)

Ministria e Pushtetit Vendor  
dhe Decentralizimit  
[www.mpvd.gov.al](http://www.mpvd.gov.al)

Ministria e Transportit dhe  
Telekomunikacionit  
[www.mtt.gov.al](http://www.mtt.gov.al)

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 1)*

Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondeve buxhetore, të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet", të ndryshuar.

**3.** Për një ndryshim në vendimin nr.677, datë 8.10.2004, të këshillit të Ministrave, "për lejimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për vazhdimin e punimeve të ndërtimit në segmentin rrugor Milot-Rrëshen, pjesë e aksit rrugor Durrës-Kukës-Morinë".

**4.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për prokurorinë e Përgjithëshme.

**5.** Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.102, datë 5.3.1999, të Këshillit të ministrave, "Për trajtimin me strehim të funksioneve politike dhe nënpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore", të ndryshuar.

**6.** Për një ndryshim në vendimin nr.64, datë 29.1.2004, të këshillit të Ministrave, "për miratimin e programit analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2004".

## **II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 17.12.2004**

### **PROJEKTLIGJE**

*(Vendime të Këshillit të Ministrave për propozim të projektligjeve)*

**1.** Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe bankës Europiane të Investimeve, për kontratën financiare, për projektin e ndërtimit të TEC-it, në Vlorë.

**2.** Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë dhe fianciare për projektin e ndërtimit të linjës 400 KV Tiranë – Podgoricë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Sh-

qiptare (KESH, sha) dhe Kreditanstalt für Eiederaufbau, Frankfurt am Main (KfE), marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt für Eiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW), si dhe të marrëveshjes së arbitrazhit, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH, sha) dhe Kreditanstalt für Eiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW).

### **VENDIME të Këshillit të Ministrave data 17.12.2004**

**1.** Për miratimin e dokumentit "Rregullorja e Shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë"

**2.** Për veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.

**3.** Për shfuqizimin e vendimit nr. 506, datë 18.7.2003, të këshillit të Ministrave "Për ndërtimin me konçesion të autostradës Rrogzhinë-Pezë-Degëzim Tiranë-Vorë-Thumanë dhe caktimin e organit shtetëror të autorizuar".

**4.** Për fillimin e procedurës së ndërtimit me konçesion, të formës "BOT" të autostradës Rrogzhinë – Tiranë (Pëzë) – Rinas – Thumanë.

**5.** Për fillimin e procedurës së Ndërtimit me konçesion, të formës "BOT", të rrugës Rrëshen – Kalimash e koridorit Durrës – Kukës – Morinë.

**6.** Për shpronësimin për interes public të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që prehen nga rehabilitimi i shkarjeve në barmash, në segmentin rrugor Ersekë -Leskovik.

**7.** Për shpronësimin për interes public të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i shkarjeve në Hotolisht, km. 89 në segmentin rrugor Librazhd-Qukës.

**8.** Për një shtesë në vendimin nr.624, datë 11.9.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes public të pasurive të paluajtëshme, që preken nga ndërtimi i rrugëve paralele Tiranë – Vorë, në superstradën Tiranë – Durrës".

**9.** Për disa ndryshime në vendimin nr.83, datë 26.2.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për tarifën telefonike dhe për pagesat elektrike nga personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar.

**10.** Për dhënie fondi ndihme familjeve që u janë dëmtuar banesat, si pasojë e fatkeqësive të ndryshme.

**11.** Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Pushtetit vendor dhe e Decentralizimit dhe qeverisë së Austrisë, të përfaqësuar nga Agjensia Austriake e Zhvillimit (ADA), për financimin e projektit "Zhvillimi rural i integruar i zonës së Kelmendit – Veriu i Shqipërisë".

**12.** Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), në cilësinë e administratorit të fondit grant, dhënë nga Japonia, për hartimin e projektit për modernizimin e sistemit shëndetësor shqiptar.

**13.** Për procedurën e dhënies së lejës së importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, për përdorim civil.

**14.** Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura.

**15.** Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të disa parcelave pyjore e kullosore nga Ministria

*(Vijon në faqen 3)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

*(Vijon nga faqja 2)*

e Bujqësisë dhe e Ushqimit Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një shtesë në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

**16.** Për administrimin e të ardhurave nga shitja e aktivëve të qëndrueshme të trupëzuara në shoqëritë anonime, me capital themeltar tërësisht shtetëror.

**17.** Për financimin e bordeve të kullimit.

**18.** Për mbështetjen e qendrave racore në blegtori.

**19.** Për një ndryshim në vendimin nr. 653, datë 25.9.2003 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve" të ndryshuar.

**20.** Për një ndryshim e shtesë në vendimin nr.238, datë 13.4.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e dhënies së lejës për lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar.

**21.** Për shpërblimin e punonjësve të Shërbimit Informativ të shtetit për vitin 2004.

**22.** Për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratimi për Presidencën.

**23.** Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për furnizimin me pulla kontrolli për barnat që përdoren në Republikën e Shqipërisë.

**24.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të zotit Arben Duka në Stamboll.

**25.** Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 638, datë 18.9.2004 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës

dhe nivelit të pagave të punonjësve të informatikës, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë.

**26.** Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë.

**27.** Për lejimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për studim – projektimin e kthimit në identitet të ndërtesës së teatrit Kombëtar për Fëmijë dhe për kthim në teatër bashkëkohor të Odeonit të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës.

## **II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 22.12.2004**

### **PROJEKTLIGJE**

*(Vendime të Këshillit të Ministrave për propozim të projektligjeve)*

**1.** Për statusin e punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit.

**2.** Për mbarështimin e blegtorisë.

**3.** Për ratifikimin e Konventës ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Hollandës, për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin.

## **VENDIME të Këshillit të Ministrave data 22.12.2004**

**1.** Për shpërblimin e personave që përfitojnë pension.

**2.** Për plotësimin e dokumentacionit të pronësisë mbi tokën që zihet nga ndërtimi i aeroportit të kukësit, të miratuar me vendimin nr.1, datë 7.1.2000, të këshillit të rregullimit të territorit të republikës së Shqipërisë.

**3.** Për miratimin e memorandumit të mirkuptimit për krijimin e Forumit rajonal të Nismës së Mi-

grimit, Azilimit dhe Kthimit të Refugjatëve.

**4.** Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë, për zgjidhjen e borxhit të republikës së Shqipërisë ndaj Rumanisë.

**5.** Për miratimin në parim të marrëveshjes specifike të përkrahjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë, për projektin për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri, me projekt pilot qarkun e Korçës.

**6.** Për tërheqjen e njohjes të republikës Arabe Demokratike Sahariane.

**7.** Për shpërblimin e ish-punonjësve të uzinës së ferrokromit, Burrel.

**8.** Për trajtimin e një pjese të punonjësve në Drejtorinë e Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

**9.** Për një ndryshim në vendimin nr. 185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor", i ndryshuar.

**10.** Për disa ndryshime në vendimin nr. 440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së ndërtimit", të ndryshuar.

**11.** Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 726, datë 21.12.2000, të këshillit të ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

**12.** Për disa ndryshime në vendimin nr. 56, datë 27.2.1992 të këshillit të ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve të Shërbimit

*(Vijon në faqen 4)*

# Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 3)

Informativ Kombëtar”, i ndryshuar.

**13.** Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të tatimeve, “të ndryshuar.

**14.** Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 54, datë 27.2.1992 të këshillit të ministrave, “Për sistemimin e pagave të Ministrisë së rendit ublik dhe ushtarakëve të Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

**15.** Për shlyerjen e detyrimeve të disa ndërmarrjeve ndaj KLESH. sha-së dhe ISSH-së.

**16.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar në projektin “shkarkimi i ujrave të zeza, Kavajë II”.

**17.** Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar në projektin “Planifikimin familjar III”.

**18.** Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Kukësit.

**19.** Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga hapja e kanalit kullues në Qytetin e Divjakës.

**20.** Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i ujësjesit të ri në qytein e Korçës.

**21.** Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga zgjerimi i aksit rrugor “Rrapi – shkolla Th Tani – kryqëzimi spital”, në qytetin e Beratit.

**22.** Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Gjirokastër – tepelenë.

**23.** Për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i dy rezervuarëve të ujit të pijshëm, në kuadër të projektit për zonën rurale të qytetit të Durrësit.

II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 29.12. 2004  
**PROJEKTLIGJE**

*(Vendime të Këshillit të Ministrave për propozim të projektligjeve)*

**1.** Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734, datë 1.02.2002, “Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar.

**2.** Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë.

**VENDIME të Këshillit të Ministrave data 29.12.2004**

**1.** Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për procedurat e licencimit.

**2.** Për disa ndryshime në vendimin nr. 786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave, “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për kualifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar.

**3.** Për mënyrën dhe kriteret e rimbursimit të barnave për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

**4.** Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga zbatimi i programit “PHARE” për projektet e rehabilitimit të kanalizimeve të ujrave të zeza, në rrugën në veri të ish-ko-

mbinatit të konservave dhe të sistemim-asfaltimit të rrugës nr. 5 (segmenti Shkolla “Ali Demi” – rruga nr.3), në qytetin e Vlorës.

**5.** Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës së varresave të reja qytetin e Shijakut.

**6.** Për miratimin në parim të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor të veprimit të fqinjësisë “CARDS 2004”.

**7.** Për një ndryshim në vendimin nr. 243, datë 26.03.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore, për vitin 2004 dhe për rishpërndarje fondesh buxhetore.

**8.** Për lejimin e shoqërisë anonime “Albtelekom” të përdorë procedurën “Prokurim i drejtëpërdrejtë” për auditimin e shoqërisë.

**9.** Për miratimin në parim të protokollit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe rajonit të Lacios, të Republikës së Italisë.

**10.** Për rishpërndarjen e limitit të të ardhurave dytësore, të vitit 2004, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe të shkencës.

**11.** Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, mirataur për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, për përballimin e pagesës së përfitimeve të paaftësisë, për personat me statusin e invalidit të punës.

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 1)*

të saj përputhjen që ajo siguron me programin e Qeverisë për konsolidimin fiskal e buxhetor, ndikimin që ajo jep në zhvillimin e sektorit privat, në konsolidimin e ekonomisë së tregut, në përmirësimin e administrimit fiskal dhe në luftën kundër evazionit, kontrabandës dhe ekonomisë informale, në mbështetjen e biznesit të vogël dhe të sektorit privat, në zbatimin e angazhimeve të marra në kuadër të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë, në krijimin e një klime mbështetëse për investitorët e huaj, në mbrojtjen e mjedisit, si dhe në decentralizimin dhe autonominë fiskale. Nga ana tjetër, deputetët e opozitës shprehën kundërshtimet e tyre për projektligjet e paketës fiskale dhe paraqitën amendamentet përkatëse, të cilat u diskutuan në komisione dhe në seancë plenare. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi i miratoi projektligjet e paketës fiskale me shumicë votash.

Më poshtë po paraqes shkurtimisht debatet e zhvilluara për çdo projektligj të paketës fiskale.

## **1. P/ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**

Amendamentet që propozohen t'i bëhen ligjit ekzistues synojnë përmirësimin e dispozitave që rregullojnë disa lloje procedurash tatimore, siç janë dispozitat që rregullojnë funksionimin e Policisë Tatimore, kontrollin dhe verifikimin në vend të tatimpaguesit nga administrata tatimore, kur ai kërkon të ç'rregjistrohet, lehtësimin e procedurave të kthimit të parave të paguara tepër nga tatimpaguesit, uljen e normave të interesit për tatimpaguesit, kur ata nuk paguajnë në kohë detyrimin tatimor, unifikimin e shkallëve të apelimit etj.

Në amendamentet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike synohet ndryshimi i përmbytjes së disa neneve, ndër të cilat më kryesoret janë:

- Neni 1, pika 1 e projektligjit. Riformulimi i propozuar synon të përcaktojë një afat kohor prej 30 ditësh për publikimin e njoftimeve administrative në buletin mujor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përfundimin e të cilit njoftimi i përgjithshëm administrativ bëhet i detyrueshëm për administratën tatimore dhe për tatimpaguesit. Vendosja e afatit për publikimin e njoftimeve administrative, sipas propozuesve të amendamentit, është kusht i domosdoshëm për rritjen e transparencës ndaj biznesit dhe për të mënjeluar abuzimet ndaj administrates fiskale.

Pas debateve për këtë amendament, Kuvendi vendosi që t'i lihet në kompetencë Ministrin të Financave që, në zbatim të ligjit, të hartojë udhëzimin për mënyrën dhe organin e publikimit të njoftimeve të përgjithshme administrative.

- Neni 4, pika 1 e projektligjit. Sipas projektligjit, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve mund të plotësojë vendet e lira nëpërmjet emërimit të përkohshëm për një

periudhë që zgjat deri në çastin e përfundimit të procedurave të konkurrimit. Në amendamentet e opozitës propozohet që të caktohet një afat limit prej një muaj për plotësimin e vendeve të lira me persona që nuk i janë nënshtruar konkurrimit. Deputetët e opozitës theksuan se mospërcaktimi i afatit nga projektligji le shteg për mënjanimin e konkurrimit në përputhje me ligjin e shërbimit civil.

Së dyti, në amendamentin e opozitës propozohet që plotësimi i vendeve të lira të punës, nëpërmjet emërimit të përkohshëm, të mos bëhet me persona jashtë administratës tatimore, siç propozohet në projektligj, por vetëm me punonjës të administratës tatimore. Një formulim i tillë, sipas propozuesve të amendamentit, synon t'i presë rrugën korrupsionit në këtë administratë.

Pas diskutimit, Kuvendi nuk e miratoi amendamentin e propozuar për këtë pikë me shumicë votash, me argumentin që formulimi i projektligjit për këtë çështje është në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

- Neni 8, pika 1, gërma “b” e projektligjit ka të bëjë me rastet kur tatimpaguesit kërkojnë të ç'rregjistrohen me vendim gjykate. Sipas propozuesve të amendamentit, synimi i tij është që të mënjanojë abuzimet e administrates tatimore për të kërkuar detyrime tatimore ndaj tatimpaguesit pas datës së njoftimit prej tij të kërkesës për ç'rregjistrim.

Ky amendament u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Neni 11 i projektligjit, i cili ka të bëjë me kthimin e tatimeve të paguara tepër dhe rimbursimin e TVSH-së. Propozuesit e amendamentit theksuan se ky reformulim synon të mënjanojë rastet e abuzimeve të administratës tatimore për kthimin e shumave të paguara më tepër nga tatimpaguesit dhe për rimbursimin e TVSH-së. Për të realizuar këtë qëllim, në amendament propozohet të shkurtrohet afati i shqyrtimit nga administrata tatimore të kërkesës së tatimpaguesit për kthimin e shumës së paguar më tepër, i cili nga 60 ditë propozohet të bëhet 30 ditë, si dhe të shkurtrohet afati për kthimin e shumës së paguar më tepër, i cili nga 60 ditë, propozohet të bëhet 45 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga tatimpaguesi.

Ky ndryshim nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash, me argumentin që për të bërë të realizueshëm kthimin e shumës së paguar më tepër ndaj tatimpaguesit nga administrata tatimore, është i nevojshëm afati 60-ditor .

Deputetët e opozitës propozuan edhe disa ndryshime të tjera në këtë nen, të cilat u miratuan pjesërisht nga Kuvendi.

- Neni 14 i projektligjit, i cili i jep të drejtë tatimpaguesit të tërheqë në çdo kohë apelimin tatimor. Deputetët e opozitës propozuan që të mos i jepet kjo e

*(Vijon në faqen 6)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 5)*

drejtë tatimpaguesit, pasi ajo bart rrezikun e mbulimit të rasteve kur hetimi tatimor zbulon shuma që duhen paguar më tepër nga tatimpaguesi ose mbulon presione të ndryshme që mund të bëjë tatimpaguesi ndaj administratës fiskale.

Ky propozim nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Neni 15 i projektligjit, që bën fjalë për apelimin në degët e tatimeve dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Deputetët e opozitës propozuan shfuqizimin e këtij neni, i cili sipas tyre, shfuqizon amendamentin e bërë vitin e mëparshëm, sipas të cilit një ankesë e tatimpaguesit që nuk merrte përgjigje brenda 30 ditëve quhej e pranuar. Ata theksuan se projektligji e detyron ankesin që nuk ka marrë përgjigje që të drejtohet në instanca të tjera tatimore ose gjykatë për të kërkuar të drejtën e tij, duke i lënë hapësirë administratës tatimore që të krijojë zvarritje në kthimin e përgjigjeve ndaj ankuesve.

Ky amendament nuk u pranua nga Kuvendi me shumicë votash, me argumentin që procedura e parashikuar në projektligj për ankimimin e tatimpaguesit është e drejtë.

- Neni 16, pika 2 e projektligjit, në të cilin propozuesit e amendamentit vendosin detyrime për administratën tatimore që të marrë përsipër dorëzimin ose dërgimin zyrtar të formularëve të deklaratave tatimore tek tatimpaguesit, në kundërshtim me projektligjin, i cili sipas amenduesve, i le hapësirë për abuzime administrates tatimore.

Ky amendament u miratua pjesërisht nga Kuvendi, i cili vendosi që në rastet kur tatimpaguesi nuk e ka marrë deklaratën tatimore, ai duhet ta kërkojë atë në organin tatimor përkatës.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

**2. P/ligji “Për një shtesë në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”.**

Amendamentet që propozohen t'i bëhen këtij projektligji kanë për qëllim shfuqizimin e taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme më 1 janar të vitit 2006, e cila është e kushtëzuar nga vendosja pas kësaj date e tatimit mbi vlerën e shtuar për shitjen e ndërtesave të reja të banimit, si dhe çdo shitje të ndërtesave të destinuar për qëllime të tjera. Heqja e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme më 1 janar 2006 propozohet për arsye se ekzistenca e kësaj takse fikse për çdo metër katror sipërfaqe ndërtimi, krahas TVSH-së, do të krijonte mbingarkesë në shitjen e ndërtesave dhe për më tepër, do të krijonte taksim të dyfishtë të tyre. Gjatë diskutimit për këtë projektligj deputetët shprehën shqetësimin se vendosja e TVSH-së për shitjen e ndërtesave të reja të banimit, si dhe çdo shitje të ndërtesave të destinuar për qëllime të tjera dhe shfuqizimi i taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme pas datës 31 dhjetor 2005, do

të ndikojë dukshëm në uljen e të ardhurave të pushetit vendor dhe rritjen e çmimit të banesave. Gjithashtu, ata theksuan se përgatitja e akteve nënligjore për kompensimin e uljes së të ardhurave të bashkive e komunave nga heqja e taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme kërkon një kohë relativisht të gjatë. Për këto arsye, si dhe për faktin që ky projektligj nuk ka efekte financiare në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit të vitit 2005, Kuvendi u ndal në nevojën e miratimit ose jo të këtij projektligji. Deputetët e maxhorancës u shprehën për miratimin e këtij projektligji, i cili sipas tyre, do të ndikojë në shpejtimin e ritmeve për përgatitjen gjatë vitit 2005 të akteve ligjore për kompensimin e uljes së të ardhurave nga organet e qeverisjes vendore. Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin. Në përfundim, Kuvendi vendosi me shumicë votash miratimin e projektligjit.

**3. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8978, date 12.12.2002 “Për taksat vendore mbi biznesin e vogël”.**

Nëpërmjet amendamenteve të projektligjit synohet të përmirësohet ligji ekzistues në këto drejtime:

- Në përmirësimin e mbledhjes dhe administrimit të taksës vendore mbi biznesin e vogël, duke e kaluar funksionin e mbledhjes së kësaj takse nga njësitë e qeverisjes vendore në degët e tatimeve.

- Në heqjen e detyrimit për rregjistrimin e përvitshëm të tatimpaguesve, duke filluar nga viti 2006.

- Në ndarjen e pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në dy kohë, përkatësisht 50 për qind më 20 prill dhe 50 për qind më 20 tetor dhe në favorizimin e bizneseve që paguajnë tatimin vjetor para datës 1 shkurt dhe 1 mars të çdo viti.

Gjatë diskutimit deputetët propozuan disa ndryshime në formulimin e neneve të projektligjit, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tij, të cilat u miratuan nga Kuvendi.

**4. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, date 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.**

Projektligji synon shfuqizimin e taksës së tonazhit për aks dhe të taksës ekzistuese të qarkullimit rrugor dhe përfshirjen e tyre në një taksë të vetme, e cila emërtohet “Taksa vjetore e qarkullimit rrugor”, diferencimin e taksës së mjeteve motorrike në shërbim të bujqësisë, duke zvogëluar taksën për to në krahasim me mjetet motorrike që përdoren për qëllime të tjera, ndryshimin e taksës së importit të automjeteve të përdorura etj.

Një nga çështjet e diskutuara kishte të bënte me mënyrën e llogaritjes së taksës për importin e automjeteve të përdorura, mbi bazën e një tablele koeficientësh, në varësi të vjetërsisë së përdorimit të

*(Vijon në faqen 7)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 6)*

mjeteve dhe ndarjes së tyre sipas llojit të lëndës djegëse që përdorin, benzinë apo naftë. Deputetët opozitarë propozuan një tabelë koeficientësh, e cila synon të përafrojë masën e pagesave aktuale me pagesën pas ristrukturimit të taksave, duke pranuar një rritje të tyre, e cila propozohet të paguhet nga mjetet e përdorura dhe që ndotin ambientin. Gjithashtu, deputetët propozuan një rritje të taksës për mjetet me naftë. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi të miratojë disa ndryshime në nivelin e koeficientëve, duke mos rënë dakord plotësisht me propozimet e opozitës.

## **5. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.**

Objekti i këtij projektligji është ulja e shkallës së tatimit mbi fitimin nga 25 për qind në 23 për qind, diferencimi i shkallës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sipas llojeve të veprimtarisë ekonomike, futja e sistemit të detyrueshëm të deklarimit të të ardhurave personale, pavarësisht nga burimi i të ardhurave, zgjerimi i bazës së tatimit të dividendëve, ndryshimi i shkallëve të tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat, duke ulur detyrimin tatimor për pagat e ulëta dhe duke shtuar një shkallë të re tatimi për pagat e larta etj.

Gjatë diskutimit të këtij projektligji u zhvilluan debate veçanërisht për ato nene, për të cilat ka patur kontestime nga shoqatat e biznesit dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë.

Një nga çështjet e ngritura prej tyre ka të bëjë me nenin 16, pika 4 të projektligjit, i cili bën fjalë për mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat, ku përfshihen edhe të ardhurat nga dividendi. Sipas projektligjit, i gjithë fitimi i realizuar nga subjektet e tatimit mbi fitimin konsiderohet dividend i pagueshëm dhe tatohet, pavarësisht nëse ai shpërndahet ose jo.

Përfaqësuesit e biznesit kërkuan që fitimi i përdorur nga këto subjekte për rritjen e kapitalit themeltar dhe për rezerva ligjore e statutore si dhe mbartja e fitimit, të mos taten. Ky propozim u mbështet nga deputetët, si masë që ndikon në rritjen e investimeve nga biznesi.

Për të njëjtin qëllim, deputetët miratuan një ndryshim tjetër në këtë nen, sipas të cilit do të konsiderohet si dividend i tatuueshëm çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim mbulimin e humbjeve dhe që nuk përbën kontribut në para të pronarëve.

Gjithashtu, për të bërë të realizueshëm depozitim nga shoqëritë tregtare tek organet tatimore brenda një afati të caktuar me ligj të vendimit të organit të tyre vendimmarrës për përdorimin e fitimit të vitit paraardhës, deputetët miratuan kaluzolën që fitimi pas tatimit, pa përfshirë rezervat e domosdoshme ligjore, të tatohet.

Deputetët e opozitës, mbi bazën e kërkesave të biznesit, nëpërmjet amendamenteve të propozuara për ndryshimin e disa neneve, kërkuan:

- Të mos taten kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, pasi ky tatim rëndon buxhetin e personave me të ardhura të vogla. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2005 të jetë 20 për qind dhe jo 23 për qind, siç propozohet në projektligj, për ta barazuar atë me nivelin që ka kjo taksë në vendet e tjera të rajonit. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Të mos miratohet neni 9 i projektligjit, i cili propozon heqjen e detyrimit të organit tatimor që të njohë pagesat e tepërta të subjekteve të tatimit mbi fitimin për shlyerjen e detyrimeve të tjera fiskale të tyre ose të rimbursojë shumat e paguara tepër nga biznesi pas një periudhe të përcaktuar me ligj, me qëllim që të mos i lihet shteg administratës tatimore të abuzojë me përcaktimin e nivelit të tatimit. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Të mos miratohet vendosja e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin tek personat që realizojnë një qarkullim vjetor prej më pak se 3 milionë lekësh në fushën e shërbimeve, masë e cila ndikon në rritjen e nivelit të taksave për biznesin e vogël. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Të zvogëlohet shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në nivelin 2 për qind, e cila i vjen në ndihmë biznesit të vogël dhe ndikon në rritjen e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, si rrjedhojë e uljes së informalitetit në mbledhjen e këtij tatimi. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Të mos miratohet propozimi për vendosjen e tatimit mbi të ardhurat për biznesin e vogël dhe të mesëm, i cili paguan tatim të thjeshtuar mbi fitimin, i cili rrit ngarkesën fiskale të këtij biznesi dhe denatyrton tatimin mbi të ardhurat, si një lloj tatimi që vendoset ndaj personave të parregjistruar në organet tatimore. Ky amendament u miratua nga Kuvendi.

- Të vendoset një afat ligjor për transferimin e të ardhurave të mbledhura nga ky tatim nga Buxheti i Shtetit tek buxheti i bashkisë ose komunës, cili do të mënjanojë bllokimet burokratike në kalimin e fondëve nga administrata qendrore tek qeverisja vendore. Ky amendament u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

## **6. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.**

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, çësh-

*(Vijon në faqen 8)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 7)*

tja kryesore që u debatua kishte të bënte me vendosjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për shitjen e ndërtesave të reja të banimit, si dhe çdo shitje të ndërtesave të destinuar për qëllime të tjera, duke filluar që nga 1 janari 2006. Deputetët ishin të mendimit që vendosja e këtij tatimi ndikon në uljen e të ardhurave të bashkive e komunave, pasi pas vendosjes së TVSH-së për ndërtimet, do të shfuqizohet taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, e cila është taksë vendore.

Deputetët u shprehën dakord në parim me vendosjen e TVSH-së për ndërtimet, por ata ishin të mendimit që kjo të bëhet në një kohë të mëvonshme, pasi të jenë marrë të gjitha masat për kompensimin e të ardhurave të bashkive e komunave, duke kaluar disa taksa nacionale në favor të tyre dhe pasi të jenë marrë masat e tjera për administrimin dhe vjeljen e TVSH-së në sektorin e ndërtimit.

Gjithashtu, deputetët diskutuan dhe nuk ranë dakord me vendosjen e TVSH-së për personat juridikë që realizojnë një xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që aktualisht janë të përjashtuar me ligj nga pagimi i saj.

Kuvendi diskutoi edhe për propozimet e paraqitura në amendamentet e opozitës lidhur me këtë projektligj, të cilat sipas propozuesve të tyre, synojnë:

- Të lehtësojnë tatimpaguesit nga pagimi i menjëhershëm i TVSH-së në zbatimin e kontratave të marrjes me qira të mallrave ose të shitjes me këste të tyre, duke propozuar që pagesat të bëhen në momentin e pagimit të kësteve dhe në përputhje me madhësinë e kështit të paguar, për të ndikuar në rritjen e investimeve. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi ra dakord me këtë amendament.

- Të lehtësojë tatimpaguesit nga pagesa e tepërt e TVSH-së për mallrat e importit, e llogaritur nga administrata tatimore mbi bazën e çmimeve të referencës, duke kërkuar që krahas llogaritjeve të organit tatimor, të shërbejnë si burim informacioni edhe dokumentet e ofruara nga furnizuesi. Ky amendament nuk u miratua nga shumica e deputetëve.

- Të përcaktojë afatin 30-ditor për Komisionin e Apelit të Tatimeve që të vendosë për kërkesën e ankuesve, i cili do të ndikojë në shkurtimin e afatit të gjyqimeve dhe të vendimeve të tij ndaj ankimeve për vlerësimin tatimor. Me shumicë votash, ky amendament nuk u miratua.

- Të shkurtojë nga 6 muaj në 3 muaj afatin që i jep të drejtë tatimpaguesit të pretendojë rimbursimin e një shume të kreditimit tatimor. Ky propozim u miratua nga shumica e deputetëve. Të zvogëlojë kufirin e mospagimit të rimbursimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore nga 400 mijë lekë në 200 mijë lekë, si dhe të vendosë para administratës tatimore detyrimin që të publikojë një buletin 3-mujor me listën e subjekteve që kanë përfituar rimbursim. Këto dy propozime nuk u miratuan me shumicë votash.

## **7. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar.**

Nëpërmjet amendamenteve që propozohen t'i bëhen këtij projektligji synohet:

- Të zbatohen angazhimet e marra ndaj Organizatës Botërore të Tregtisë dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë që vendi ynë ka nënshkruar me vendet e rajonit për uljen dhe reduktimin e tarifave doganore;

- Të merren në konsideratë kërkesat e biznesit për uljen e tarifave doganore për disa grupe mallrash, të cilat shërbejnë si lëndë e parë për metalurgjinë, industrinë e lehtë dhe industrinë ushqimore.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare përfaqësuesit e Qeverisë informuan Kuvendin se projektligji është në përputhje me programin e Qeverisë për liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë, veçanërisht me vendet e rajonit, me memorandumun e mirëkuptimit për lehtësimin e tregtisë dhe me procesin e negociatave të stabilizim asociimit me BE-në.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentin që ai nuk merr parasysh plotësisht kërkesat e biznesit për uljen e tarifave doganore për lëndët e para të importit që nuk mund të prodhohen në vend dhe të ambalazheve që përdoren nga shumë biznese në sektorin agroushqimor, ndërkohë që tarifat doganore për produktet e gatshme propozohen të bëhen zero. Sipas tyre, ndjekja e kësaj politike tarifore dëmton konkurrencën e lirë dhe biznesin vendas dhe dekurajon investitorët.

Lidhur me kërkesat që parashtruan disa deputetë për të mos ulur tarifën doganore për disa grupmallrash si pije alkoolike, mobilje etj, përfaqësuesit e Qeverisë informuan deputetët se ulja e tarifave doganore për këto grupmallrash është e kushtëzuar nga zbatimi i detyrimeve që ka Qeveria me Organizatën Botërore të Tregtisë.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash, duke përfshirë në tabelat shoqëruese të tij propozimin e Këshillit të Ministrave të bërë në korrik të këtij viti për heqjen e tarifës doganore për gazet e naftës dhe hidrokarburet e tjera gazotike, lëndët djegëse minerare dhe produktet e distilimit të tyre, substancat bituminoze dhe dyllet minerare.

## **8. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.**

Nëpërmjet amendamenteve që propozohen t'i bëhen ligjit ekzistues, kërkohet që organet tatimore të mbledhin nga tatimpaguesit vetëm shumat e kontributeve bruto, pa zbritur përfitimet e të siguruarve. Projektligji krijon mundësinë që shpenzimet që do të kryejë tatimpaguesi për punëmarrësit, që përfitojnë nga ske-

*(Vijon në faqen 9)*



# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 8)*

ma e sigurimeve shoqërore, të paraqiten në organet e sigurimeve shoqërore me dokumente vërtetuese të përfitimeve për të marrë shumat që u takojnë sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Amendamentet sigurojnë forcimin e kontrollit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore tek tatimpaguesi për rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, të cilat përballohen nga fondet e ISSH-së dhe të kontrollit të shpenzimeve për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore përpara kryerjes së tyre.

Deputetët e opozitës shprehën shqetësimin se niveli i tarifës për sigurimet shoqërore është shumë i lartë, ndërkohë që niveli i të ardhurave nga kjo tarifë është mjaft i ulët, se ndryshimet ligjore të propozuara rrisin presionin fiskal në sektorin e sigurimeve shoqërore dhe ulin efikasitetin e tij, se projektligji zgjeron llojet dhe natyrën e të ardhurave që i nënshtrohen kësaj tarife, se ai vështirëson skemën e përfitimit të shpërblimeve për raporte mjekësore, për asistim pjesor të pagës apo për përfitime të tjera që njeh ligji për sigurimet shoqërore. Prandaj ata u shprehën kundër tij.

## **9.P/ligji “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”**

Shqyrtimi i projektbuxhetit filloi me prezantimin e tij nga Ministri i Financave në një mbledhje të përbashkët të kryetarëve të komisioneve të përhershme të Kuvendit dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit zhvilloi disa takime me përfaqësues të grupeve të interesit, si të Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim, të Lëvizjes “Mjaft”, duke vlerësuar opinionet e tyre për një shpërndarje më të mirë të shpenzimeve buxhetore sipas sektorëve të ekonomisë dhe për mbështetjen prioritare të sektorëve të arsimit dhe të shëndetësisë. Njëkohësisht, ky Komision vlerësoi syzjerimet e përfaqësuesve të Shoqatës së Bashkive, për të marrë më shumë kompetenca në administrimin e shpenzimeve të buxhetit të pushtetit vendor, duke u vënë atyre në dispozicion si transferta të kushtëzuara fondet për investime në arsim, shëndetësi dhe fondet për ndihmën ekonomike.

Diskutimi i projektbuxhetit u zhvillua mbi bazën e një programi pune të veçantë, i cili siguron bashkërendimin e punës midis Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit dhe komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit. Gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit deputetët dhanë vlerësimet përkatëse.

Deputetët e maxhorancës dhanë vlerësime pozitive për projektbuxhetin dhe vunë në pah tiparet e tij kryesore si më poshtë:

1. Treguesit kryesorë të projektbuxhetit mbështeten në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik e Social të vendit dhe janë në përputhje me Programin Afatmesëm Buxhetor për vitet 2005-2007.

2. Projektbuxheti siguron qendrueshmërinë e treguesve makroekonomikë, rritjen e të ardhurave fiskale dhe të shpenzimeve buxhetore, duke i dhënë përparësi sektorëve të arsimit dhe të shëndetësisë.

3. Treguesit e projektbuxhetit që parashikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e tij janë realistë dhe të realizueshëm, ata mbështeten në mundësitë dhe kapacitetet e organeve tatimore për të mbledhur të ardhura dhe të administratës shtetërore për të kryer shpenzime, duke synuar të mos shpërdorohen fondet e Buxhetit të Shtetit gjatë fushatës elektorale.

4. Projektbuxheti thëllon reformën e decentralizimit, rritjen e autonomisë dhe të përgjegjësisë financiare të pushtetit vendor, duke i kaluar këtyre organeve një pjesë të rëndësishme të përgjegjësisë për përdorimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Ai parashikon rritjen e granteve të buxhetit për bashkitë dhe komunat që sigurojnë më pak të ardhura.

5. Në projektbuxhet janë parashikuar shpenzimet për zbatimin e politikave, për mbështetjen financiare për shtresat në nevojë, për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, për kompensimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, për pagesën e paaftësisë dhe të papunësisë etj.

Deputetët e opozitës u shprehën kundër miratimit të projektbuxhetit të vitit 2005, duke pretenduar se treguesit e këtij projektbuxheti janë më të përkeqësuar në krahasim me vitin e mëparshëm dhe nuk përmbushin kërkesat e ekonomisë për investime në sektorët parësorë të ekonomisë.

1. Treguesit e projektbuxhetit kanë pësuar rënie nga viti 1999 në vitin 2004 dhe parashikohen më të përkeqësuar në vitin 2005.

2. Rritja e Prodhimit të brendshëm Bruto shoqërohet me rritjen e deficitit në bilancin tregtar, duke parashikuar nivel të ulët eksportesh në krahasim me importet. Struktura e PBB-së është përkeqësuar, duke u zvogëluar pjesa që zenë industria dhe bujqësia. Mbajtja e nivelit të ulët të inflacionit në tërësi shoqërohet me rritje çmimesh në disa sektorë, duke thelluar varfërinë, duke dobësuar fuqinë blerëse dhe duke rritur koston e prodhimeve. Rritja ekonomike shoqërohet me shtim të numrit të të papunëve. Borxhi publik rritet dhe kursimet e popullsisë përdoren për të financuar këtë deficit, duke ulur pjesën që përdoret për të kredituar ekonominë private.

3. Projektbuxheti dëshmon për përkeqësim të administrimit dhe të arkëtimit të të ardhurave nga tatimet dhe taksat, për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit dhe të ekonomisë informale.

4. Shpenzimet buxhetore janë me rënie nga viti në vit, e cila sjell rënien e shpenzimeve të parashikuara për investime dhe për shërbime. Veç rënies në total të shpenzimeve, vihet re deformim i strukturës së tyre, duke pakësuar pjesën e shpenzimeve që shkon

*(Vijon në faqen 10)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 9)*

për investime, në favor të rritjes së shpenzimeve korrente. Është rritur pjesa e shpenzimeve që përdoren për sigurime shoqërore dhe asistim social, gjë që shoqërohet me rënien e investimeve publike në arsim, shëndetësi e kulturë.

5. Projektbuxheti nuk mbështet sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë si sektorë prioritarë, në të cilët vihet re rënie e investimeve.

6. Në projektbuxhet vihet re zvogëlim i granteve për pushtetin lokal dhe për shtresat në nevojë, veçanërisht për pensionistët.

Deputetët e opozitës i paraqitën Kuvendit disa amendamente për ndryshimin e projektbuxhetit të vitit 2005, të cilat sipas tyre, synojnë të zbusin mangësitë e konstatuara prej tyre në këtë projektligj. Synimi kryesor i këtyre amendamenteve ishte rritja e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, të cilat shoqërohen me rritje të shpenzimeve buxhetore, veçanërisht të shpenzimeve për investime.

Gjatë shqyrtimit të amendamenteve të paraqitura nga opozita, deputetët e maxhorancës u shprehën kundër tyre, me argumentin që niveli i të ardhurave të parashikuara në projektbuxhet mbështetet në mundësitë e organeve tatimore për mbledhjen e tyre dhe ai nuk mund të rritet më tej, pasi kjo rritje e të ardhurave do të ishte e pabazuar dhe e parealizueshme dhe do të ndikonte në parashikimin më të lartë dhe fiktiv të shpenzimeve buxhetore, duke krijuar mundësi shpërdorimesh të shpenzimeve gjatë fushatës elektorale.

Gjatë shqyrtimit të shifrave të projektbuxhetit Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit u ndal në mënyrë të vecantë në shpërndarjen e shpenzimeve sipas sektorëve të ekonomisë dhe në efektivitetin e përdorimit të tyre. Ai shqyrtoi propozimet e komisioneve të përhershme të Kuvendit për shtim shpenzimesh për institucionet e pavarura dhe për disa institucione të tjera, si dhe për disa diskutere. Komisioni i Ekonomisë i vlerësoi drejt këto kërkesa, por në pamundësi të gjetjes së burimeve financiare për plotësimin e tyre tej projektbuxhetit të parashikuar, mori në konsideratë disa prej tyre që i vlerësoi si të domosdoshme dhe në veçanti, nevojat për investime.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi disa ndryshime në projektbuxhetin e paraqitur, ndër të cilat më kryesoret janë:

1. Rritja e fondit të pensioneve nga 4 për qind që ishte parashikuar në projektin e Qeverisë, në 10 për qind, duke filluar nga 1 qershori i vitit 2005.

2. Rritja e fondit të pagave për të përbulluar rritjen më të lartë se parashikimi të pagave në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë.

3. Përmirësimi i reformës së decentralizimit të pushtetit vendor, duke përfshirë në ligj tabelën e ndarjes së fondeve për investime në arsim, shëndetësi dhe për ndihmën ekonomike, si grant i kushtëzuar, si dhe

duke përmirësuar tabelën e projektligjit që përcakton ndarjen e funksioneve midis pushtetit qendror dhe atij vendor.

4. Mbështetja më e madhe e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës në zonat urbane dhe rurale, sidomos për rikonstruksionin e ujësjellësave, të kanalizimeve, të rrugëve, asfaltimeve etj.

5. Reduktimi i kompetencës së rialokimeve buxhetore të Këshillit të Ministrave, për të rritur më tej kontrollin e Kuvendit në zbatimin e buxhetit etj.

Kuvendi e miratoi projektbuxhetin me shumicë votash, së bashku me ndryshimet e propozuara nga Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit në nenet e projektligjit dhe në tabelat shoqëruese të tij. Opozita votoi kundër projektligjit. nuk paguajnë në kohë detyrimin tatimor, unifikimin e shkallëve të apelimit etj.

Në amendamentet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike synohet ndryshimi i përmbajtjes së disa neneve, ndër të cilat më kryesoret janë:  
- Neni 1, pika 1 e projektligjit. Riformulimi i propozuar synon të përcaktojë një afat kohor prej 30 ditësh për publikimin e njoftimeve administrative në buletin mujor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përfundimin e të cilit njoftimi i përgjithshëm administrativ bëhet i detyrueshëm për administratën tatimore dhe për tatimpaguesit. Vendosja e afatit për publikimin e njoftimeve administrative, sipas propozuesve të amendamentit, është kusht i domosdoshëm për rritjen e transparencës ndaj biznesit dhe për të mënjanuar abuzimet ndaj administrates fiskale. Pas debateve për këtë amendament, Kuvendi vendosi që t'i lihet në kompetencë Ministrin të Financave që, në zbatim të ligjit, të hartojë udhëzimin për mënyrën dhe organin e publikimit të njoftimeve të përgjithshme administrative.

- Neni 4, pika 1 e projektligjit. Sipas projektligjit, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve mund të plotësojë vendet e lira nëpërmjet emërimit të përkohshëm për një periudhë që zgjat deri në çastin e përfundimit të procedurave të konkurrimit. Në amendamentet e opozitës propozohet që të caktohet një afat limit prej një muaj për plotësimin e vendeve të lira me persona që nuk i janë nënshtruar konkurrimit. Deputetët e opozitës theksuan se mospërcatktimi i afatit nga projektligji le shteg për mënjanimin e konkurrimit në përputhje me ligjin e shërbimit civil.

Së dyti, në amendamentin e opozitës propozohet që plotësimi i vendeve të lira të punës, nëpërmjet emërimit të përkohshëm, të mos bëhet me persona jashtë administratës tatimore, siç propozohet në projektligj, por vetëm me punonjës të administratës tatimore. Një formulim i tillë, sipas propozuesve të amendamentit, synon t'i presë rrugën korrupsionit në këtë administratë.

*(Vijon në faqen 11)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 10)*

Pas diskutimit, Kuvendi nuk e miratoi amendamentin e propozuar për këtë pikë me shumicë votash, me argumentin që formulimi i projektligjit për këtë çështje është në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

- Neni 8, pika 1, gërma "b" e projektligjit ka të bëjë me rastet kur tatimpaguesit kërkojnë të ç'rregjistrohen me vendim gjykatë. Sipas propozuesve të amendamentit, synimi i tij është që të mënjanojë abuzimet e administrates tatimore për të kërkuar detyrime tatimore ndaj tatimpaguesit pas datës së njoftimit prej tij të kërkesës për ç'rregjistrim.

Ky amendament u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Neni 11 i projektligjit, i cili ka të bëjë me kthimin e tatimeve të paguara tepër dhe rimbursimin e TVSH-së. Propozuesit e amendamentit theksuan se ky riformulim synon të mënjanojë rastet e abuzimeve të administratës tatimore për kthimin e shumave të paguara më tepër nga tatimpaguesit dhe për rimbursimin e TVSH-së. Për të realizuar këtë qëllim, në amendament propozohet të shkurtrohet afati i shqyrtimit nga administrata tatimore të kërkesës së tatimpaguesit për kthimin e shumës së paguar më tepër, i cili nga 60 ditë propozohet të bëhet 30 ditë, si dhe të shkurtrohet afati për kthimin e shumës së paguar më tepër, i cili nga 60 ditë, propozohet të bëhet 45 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës nga tatimpaguesi.

Ky ndryshim nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash, me argumentin që për të bërë të realizueshëm kthimin e shumës së paguar më tepër ndaj tatimpaguesit nga administrata tatimore, është i nevojshëm afati 60-ditor .

Deputetët e opozitës propozuan edhe disa ndryshime të tjera në këtë nen, të cilat u miratuan pjesërisht nga Kuvendi.

- Neni 14 i projektligjit, i cili i jep të drejtë tatimpaguesit të tërheqë në çdo kohë apelimin tatimor. Deputetët e opozitës propozuan që të mos i jepet kjo e drejtë tatimpaguesit, pasi ajo bart rrezikun e mbulimit të rasteve kur hetimi tatimor zbulon shuma që duhen paguar më tepër nga tatimpaguesi ose mbulon presione të ndryshme që mund të bëjë tatimpaguesi ndaj administratës fiskale.

Ky propozim nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Neni 15 i projektligjit, që bën fjalë për apelimin në degët e tatimeve dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Deputetët e opozitës propozuan shfuqizimin e këtij neni, i cili sipas tyre, shfuqizon amendamentin e bërë vitin e mëparshëm, sipas të cilit një ankesë e tatimpaguesit që nuk merrte përgjigje brenda 30 ditëve quhej e pranuar. Ata theksuan se projektligji e detyron ankuesin që nuk ka marrë përgjigje që të drejtohet në instanca të tjera tatimore ose gjykatë për të kërkuar të drejtën e tij, duke i lënë hapësirë

administratës tatimore që të krijojë zvarritje në kthimin e përgjigjeve ndaj ankuesve.

Ky amendament nuk u pranua nga Kuvendi me shumicë votash, me argumentin që procedura e parashikuar në projektligj për ankimin e tatimpaguesit është e drejtë.

- Neni 16, pika 2 e projektligjit, në të cilin propozuesit e amendamentit vendosin detyrime për administratën tatimore që të marrë përsipër dorëzimin ose dërgimin zyrtar të formularëve të deklaratave tatimore tek tatimpaguesit, në kundërshtim me projektligjin, i cili sipas amenduesve, i le hapësirë për abuzime administrates tatimore.

Ky amendament u miratua pjesërisht nga Kuvendi, i cili vendosi që në rastet kur tatimpaguesi nuk e ka marrë deklaratën tatimore, ai duhet ta kërkojë atë në organin tatimor përkatës.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

**2. P/ligji "Për një shtesë në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore".**

Amendamentet që propozohen t'i bëhen këtij projektligji kanë për qëllim shfuqizimin e taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme më 1 janar të vitit 2006, e cila është e kushtëzuar nga vendosja pas kësaj date e tatimit mbi vlerën e shtuar për shitjen e ndërtesave të reja të banimit, si dhe çdo shitje të ndërtesave të destinuar për qëllime të tjera. Heqja e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme më 1 janar 2006 propozohet për arsye se ekzistenca e kësaj takse fikse për çdo metër katror sipërfaqe ndërtimi, krahas TVSH-së, do të krijonte mbingarkesë në shitjen e ndërtesave dhe për më tepër, do të krijonte taksim të dyfishtë të tyre. Gjatë diskutimit për këtë projektligj deputetët shprehën shqetësimin se vendosja e TVSH-së për shitjen e ndërtesave të reja të banimit, si dhe çdo shitje të ndërtesave të destinuar për qëllime të tjera dhe shfuqizimi i taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme pas datës 31 dhjetor 2005, do të ndikojë dukshëm në uljen e të ardhurave të pushtetit vendor dhe rritjen e çmimit të banesave. Gjithashtu, ata theksuan se përgatitja e akteve nënligjore për kompensimin e uljes së të ardhurave të bashkive e komunave nga heqja e taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme kërkon një kohë relativisht të gjatë. Për këto arsye, si dhe për faktin që ky projektligj nuk ka efekte financiare në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit të vitit 2005, Kuvendi u ndal në nevojën e miratimit ose jo të këtij projektligji. Deputetët e maxhorancës u shprehën për miratimin e këtij projektligji, i cili sipas tyre, do të ndikojë në shpejtimin e ritmeve për përgatitjen gjatë vitit 2005 të akteve ligjore për kompensimin e uljes së të ardhurave nga organet e qeverisjes vendore. De-

*(Vijon në faqen 12)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 11)*

putetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin. Në përfundim, Kuvendi vendosi me shumicë votash miratimin e projektligjit.

**3. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8978, date 12.12.2002 “Për taksat vendore mbi biznesin e vogël”.**

Nëpërmjet amendamenteve të projektligjit synohet të përmirësohet ligji ekzistues në këto drejtime:

- Në përmirësimin e mbledhjes dhe administrimit të taksës vendore mbi biznesin e vogël, duke e kaluar funksionin e mbledhjes së kësaj takse nga njësitë e qeverisjes vendore në degët e tatimeve.

- Në heqjen e detyrimit për rregjistrimin e përvitshëm të tatimpaguesve, duke filluar nga viti 2006.

- Në ndarjen e pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në dy kohë, përkatësisht 50 për qind më 20 prill dhe 50 për qind më 20 tetor dhe në favorizimin e bizneseve që paguajnë tatimin vjetor para datës 1 shkurt dhe 1 mars të çdo viti.

Gjatë diskutimit deputetët propozuan disa ndryshime në formulimin e neneve të projektligjit, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tij, të cilat u miratuan nga Kuvendi.

**4. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8977, date 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.**

Projektligji synon shfuqizimin e taksës së tonazhit për aks dhe të taksës ekzistuese të qarkullimit rrugor dhe përfshirjen e tyre në një taksë të vetme, e cila emërtohet “Taksa vjetore e qarkullimit rrugor”, diferencimin e taksës së mjeteve motorrike në shërbim të bujqësisë, duke zvogëluar taksën për to në krahasim me mjetet motorrike që përdoren për qëllime të tjera, ndryshimin e taksës së importit të automjeteve të përdorura etj.

Një nga çështjet e diskutuara kishte të bënte me mënyrën e llogaritjes së taksës për importin e automjeteve të përdorura, mbi bazën e një table koeficientësh, në varësi të vjetërsisë së përdorimit të mjeteve dhe ndarjes së tyre sipas llojit të lëndës djegëse që përdorin, benzinë apo naftë. Deputetët opozitarë propozuan një tabelë koeficientësh, e cila synon të përafrojë masën e pagesave aktuale me pagesën pas ristrukturimit të taksave, duke pranuar një rritje të tyre, e cila propozohet të paguhet nga mjetet e përdorura dhe që ndotin ambientin. Gjithashtu, deputetët propozuan një rritje të taksës për mjetet me naftë. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi vendosi të miratojë disa ndryshime në nivelin e koeficientëve, duke mos rënë dakord plotësisht me propozimet e opozitës.

**5. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.**

Objekti i këtij projektligji është ulja e shkallës së tatimit mbi fitimin nga 25 për qind në 23 për qind, diferencimi i shkallës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sipas llojeve të veprimtarisë ekonomike, futja e sistemit të detyrueshëm të deklarimit të të ardhurave personale, pavarësisht nga burimi i të ardhurave, zgjerimi i bazës së tatimit të dividendëve, ndryshimi i shkallëve të tatimit mbi të ardhurat personale nga pagat, duke ulur detyrimin tatimor për pagat e ulëta dhe duke shtuar një shkallë të re tatimi për pagat e larta etj.

Gjatë diskutimit të këtij projektligji u zhvilluan debate veçanërisht për ato nene, për të cilat ka patur kontestime nga shoqatat e biznesit dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë.

Një nga çështjet e ngritura prej tyre ka të bëjë me nenin 16, pika 4 të projektligjit, i cili bën fjalë për mbajtjen në burim të tatimit mbi të ardhurat, ku përfshihen edhe të ardhurat nga dividendi. Sipas projektligjit, i gjithë fitimi i realizuar nga subjektet e tatimit mbi fitimin konsiderohet dividend i pagueshëm dhe tatohet, pavarësisht nëse ai shpërndahej ose jo.

Përfaqësuesit e biznesit kërkuan që fitimi i përdorur nga këto subjekte për rritjen e kapitalit themeltar dhe për rezerva ligjore e statutore si dhe mbartja e fitimit, të mos tatohen. Ky propozim u mbështet nga deputetët, si masë që ndikon në rritjen e investimeve nga biznesi.

Për të njëjtin qëllim, deputetët miratuan një ndryshim tjetër në këtë nen, sipas të cilit do të konsiderohet si dividend i tatueshëm çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim mbulimin e humbjeve dhe që nuk përbën kontribut në para të pronarëve.

Gjithashtu, për të bërë të realizueshëm depozitimin nga shoqëritë tregtare tek organet tatimore brenda një afati të caktuar me ligj të vendimit të organit të tyre vendimmarrës për përdorimin e fitimit të vitit paraardhës, deputetët miratuan kaluzolën që fitimi pas tatimit, pa përfshirë rezervat e domosdoshme ligjore, të tatohet.

Deputetët e opozitës, mbi bazën e kërkesave të biznesit, nëpërmjet amendamenteve të propozuara për ndryshimin e disa neneve, kërkuan:

- Të mos tatohen kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, pasi ky tatim rëndon buxhetin e personave me të ardhura të vogla. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2005 të jetë 20 për qind dhe jo 23 për qind, siç propozohet në projektligj, për ta barazuar atë me nivelin që ka kjo taksë në vendet e tjera të rajonit. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

*(Vijon në faqen 13)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 12)*

- Të mos miratohet neni 9 i projektligjit, i cili propozon heqjen e detyrimit të organit tatimor që të njohë pagesat e tepërta të subjekteve të tatimit mbi fitimin për shlyerjen e detyrimeve të tjera fiskale të tyre ose të rimbursojë shumat e paguara tepër nga biznesi pas një periudhe të përcaktuar me ligj, me qëllim që të mos i lihet shteg administratës tatimore të abuzojë me përcaktimin e nivelit të tatimit. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Të mos miratohet vendosja e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin tek personat që realizojnë një qarkullim vjetor prej më pak se 3 milionë lekësh në fushën e shërbimeve, masë e cila ndikon në rritjen e nivelit të taksave për biznesin e vogël. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Të zvogëlohet shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në nivelin 2 për qind, e cila i vjen në ndihmë biznesit të vogël dhe ndikon në rritjen e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, si rrjedhojë e uljes së informalitetit në mbledhjen e këtij tatimi. Ky amendament nuk u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

- Të mos miratohet propozimi për vendosjen e tatimit mbi të ardhurat për biznesin e vogël dhe të mesëm, i cili paguan tatim të thjeshtuar mbi fitimin, i cili rrit ngarkesën fiskale të këtij biznesi dhe denatyrton tatimin mbi të ardhurat, si një lloj tatimi që vendoset ndaj personave të parregjistruar në organet tatimore. Ky amendament u miratua nga Kuvendi.

- Të vendoset një afat ligjor për transferimin e të ardhurave të mbledhura nga ky tatim nga Buxheti i Shtetit tek buxheti i bashkisë ose komunës, cili do të mënjanojë bllokimet burokratike në kalimin e fondëve nga administrata qendrore tek qeverisja vendore. Ky amendament u miratua nga Kuvendi me shumicë votash.

**6. P/ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.**

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, çështja kryesore që u debatua kishte të bënte me vendosjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për shitjen e ndërtesave të reja të banimit, si dhe çdo shitje të ndërtesave të destinuar për qëllime të tjera, duke filluar që nga 1 janari 2006. Deputetët ishin të mendimit që vendosja e këtij tatimi ndikon në uljen e të ardhurave të bashkive e komunave, pasi pas vendosjes së TVSH-së për ndërtimet, do të shfuqizohet taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, e cila është taksë vendore.

Deputetët u shprehën dakord në parim me vendosjen e TVSH-së për ndërtimet, por ata ishin të mendimit që kjo të bëhet në një kohë të mëvonshme, pasi të jenë marrë të gjitha masat për kompensimin e të ardhurave të bashkive e komunave, duke kaluar disa taksa nacionale në favor të tyre dhe pasi të jenë mar-

rë masat e tjera për administrimin dhe vjeljen e TVSH-së në sektorin e ndërtimit.

Gjithashtu, deputetët diskutuan dhe nuk ranë dakord me vendosjen e TVSH-së për personat juridikë që realizojnë një xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që aktualisht janë të përjashtuar me ligj nga pagimi i saj.

Kuvendi diskutoi edhe për propozimet e paraqitura në amendamentet e opozitës lidhur me këtë projektligj, të cilat sipas propozuesve të tyre, synojnë:

- Të lehtësojnë tatimpaguesit nga pagimi i menjëherëshëm i TVSH-së në zbatimin e kontratave të marrjes me qira të mallrave ose të shitjes me këste të tyre, duke propozuar që pagesat të bëhen në momentin e pagimit të kësteve dhe në përputhje me madhësinë e kështit të paguar, për të ndikuar në rritjen e investimeve. Në përfundim të diskutimit, Kuvendi ra dakord me këtë amendament.

- Të lehtësojë tatimpaguesit nga pagesa e tepërt e TVSH-së për mallrat e importit, e llogaritur nga administrata tatimore mbi bazën e çmimeve të referencës, duke kërkuar që krahas llogaritjeve të organit tatimor, të shërbejnë si burim informacioni edhe dokumentet e ofruara nga furnizuesi. Ky amendament nuk u miratua nga shumica e deputetëve.

- Të përcaktojë afatin 30-ditor për Komisionin e Apelit të Tatimeve që të vendosë për kërkesën e ankuesve, i cili do të ndikojë në shkurtimin e afatit të gjykimeve dhe të vendimeve të tij ndaj ankimeve për vlerësimin tatimor. Me shumicë votash, ky amendament nuk u miratua.

- Të shkurtojë nga 6 muaj në 3 muaj afatin që i jep të drejtë tatimpaguesit të pretendojë rimbursimin e një shume të kreditimit tatimor. Ky propozim u miratua nga shumica e deputetëve. Të zvogëlojë kufirin e mospagimit të rimbursimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore nga 400 mijë lekë në 200 mijë lekë, si dhe të vendosë para administratës tatimore detyrimin që të publikojë një buletin 3-mujor me listën e subjekteve që kanë përfutur rimbursim. Këto dy propozime nuk u miratuan me shumicë votash.

**7. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar.**

Nëpërmjet amendamenteve që propozohen t'i bëhen këtij projektligji synohet:

- Të zbatohen angazhimet e marra ndaj Organizatës Botërore të Tregtisë dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë që vendi ynë ka nënshkruar me vendet e rajonit për uljen dhe reduktimin e tarifave doganore;

- Të merren në konsideratë kërkesat e biznesit për uljen e tarifave doganore për disa grupe mallrash, të cilat shërbejnë si lëndë e parë për metalurgjinë, industrinë e lehtë dhe industrinë ushqimore.

*(Vijon në faqen 14)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 13)*

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare përfaqësuesit e Qeverisë informuan Kuvendin se projektligji është në përputhje me programin e Qeverisë për liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë, veçanërisht me vendet e rajonit, me memorandumun e mirëkuptimit për lehtësimin e tregtisë dhe me procesin e negociatave të stabilizim asociimit me BE-në.

Deputetët e opozitës e kundërshtuan projektligjin, me argumentin që ai nuk merr parasysh plotësisht kërkesat e biznesit për uljen e tarifave doganore për lëndët e para të importit që nuk mund të prodhohen në vend dhe të ambalazheve që përdoren nga shumë biznese në sektorin agrorshqimor, ndërkohë që tarifat doganore për produktet e gatshme propozohen të bëhen zero. Sipas tyre, ndjekja e kësaj politike tarifore dëmton konkurrencën e lirë dhe biznesin vendas dhe dekurajon investitorët.

Lidhur me kërkesat që parashtruan disa deputetë për të mos ulur tarifat doganore për disa grupmallrash si pije alkoolike, mobilje etj, përfaqësuesit e Qeverisë informuan deputetët se ulja e tarifave doganore për këto grupmallrash është e kushtëzuar nga zbatimi i detyrimeve që ka Qeveria me Organizatën Botërore të Tregtisë.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash, duke përfshirë në tabelat shoqëruese të tij propozimin e Këshillit të Ministrave të bërë në korrik të këtij viti për heqjen e tarifës doganore për gazet e naftës dhe hidrokarburet e tjera gazotike, lëndët djegëse minerare dhe produktet e distilimit të tyre, substancat bituminoze dhe dyllet minerare.

**8. P/ligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”**

Nëpërmjet amendamenteve që propozohen t'i bëhen ligjit ekzistues, kërkohet që organet tatimore të mbledhin nga tatimpaguesit vetëm shumat e kontributeve bruto, pa zbritur përfitimet e të siguruarve. Projektligji krijon mundësinë që shpenzimet që do të kryejë tatimpaguesi për punëmarrësit, që përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, të paraqiten në organet e sigurimeve shoqërore me dokumente vërtetuese të përfitimeve për të marrë shumat që u takojnë sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Amendamentet sigurojnë forcimin e kontrollit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore tek tatimpaguesi për rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, të cilat përballohen nga fondet e ISSH-së dhe të kontrollit të shpenzimeve për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore përpara kryerjes së tyre.

Deputetët e opozitës shprehën shqetësimin se niveli i tarifës për sigurimet shoqërore është shumë i lartë, ndërkohë që niveli i të ardhurave nga kjo tarifë është mjaft i ulët, se ndryshimet ligjore të propozuara rri-

sin presionin fiskal në sektorin e sigurimeve shoqërore dhe ulin efikasitetin e tij, se projektligji zgjeron llojet dhe natyrën e të ardhurave që i nënshtrohen kësaj tarife, se ai vështirëson skemën e përfitimit të shpërblimeve për raporte mjekësore, për asistim pjesor të pagës apo për përfitime të tjera që njeh ligji për sigurimet shoqërore. Prandaj ata u shprehën kundër tij.

**9. P/ligji “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”.** Shqyrtimi i projektbuxhetit filloi me prezantimin e tij nga Ministri i Financave në një mbledhje të përbashkët të kryetarëve të komisioneve të përhershme të Kuvendit dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare. Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit zhvilloi disa takime me përfaqësues të grupeve të interesit, si të Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim, të Lëvizjes “Mjaft”, duke vlerësuar opinionet e tyre për një shpërndarje më të mirë të shpenzimeve buxhetore sipas sektorëve të ekonomisë dhe për mbështetjen prioritarë të sektorëve të arsimit dhe të shëndetësisë. Njëkohësisht, ky Komision vlerësoi syzjerimet e përfaqësuesve të Shoqatës së Bashkive, për të marrë më shumë kompetenca në administrimin e shpenzimeve të buxhetit të pushtetit vendor, duke u vënë atyre në dispozicion si transferta të kushtëzuara fondet për investime në arsim, shëndetësi dhe fondet për ndihmën ekonomike.

Diskutimi i projektbuxhetit u zhvillua mbi bazën e një programi pune të veçantë, i cili siguron bashkërendimin e punës midis Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit dhe komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit. Gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit deputetët dhanë vlerësimet përkatëse.

Deputetët e maxhorancës dhanë vlerësime pozitive për projektbuxhetin dhe vunë në pah tiparet e tij kryesore si më poshtë:

1. Treguesit kryesorë të projektbuxhetit mbështeten në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik e Social të vendit dhe janë në përputhje me Programin Afatmesëm Buxhetor për vitet 2005-2007.
2. Projektbuxheti siguron qendrueshmërinë e treguesve makroekonomikë, rritjen e të ardhurave fiskale dhe të shpenzimeve buxhetore, duke i dhënë përparësi sektorëve të arsimit dhe të shëndetësisë.
3. Treguesit e projektbuxhetit që parashikojnë të ardhurat dhe shpenzimet e tij janë realistë dhe të realizueshëm, ata mbështeten në mundësitë dhe kapacitetet e organeve tatimore për të mbledhur të ardhura dhe të administratës shtetërore për të kryer shpenzime, duke synuar të mos shpërdorohen fondet e Buxhetit të Shtetit gjatë fushatës elektorale.
4. Projektbuxheti thëllon reformën e decentralizimit, rritjen e autonomisë dhe të përgjegjësisë financiare të pushtetit vendor, duke i kaluar këtyre organeve

*(Vijon në faqen 15)*

# NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2004

*(Vijon nga faqja 14)*

një pjesë të rendësishme të përgjegjësive për përdorimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Ai parashikon rritjen e granteve të buxhetit për bashkitë dhe komunat që sigurojnë më pak të ardhura.

5. Në projektbuxhet janë parashikuar shpenzimet për zbatimin e politikave, për mbështetjen financiare për shtresat në nevojë, për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, për kompensimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, për pagesën e paafëtisë dhe të papunësisë etj.

Deputetët e opozitës u shprehën kundër miratimit të projektbuxhetit të vitit 2005, duke pretenduar se treguesit e këtij projektbuxheti janë më të përkeqësuar në krahasim me vitin e mëparshëm dhe nuk përbushin kërkesat e ekonomisë për investime në sektorët parësorë të ekonomisë.

1. Treguesit e projektbuxhetit kanë pësuar rënie nga viti 1999 në vitin 2004 dhe parashikohen më të përkeqësuar në vitin 2005.

2. Rritja e Prodhimit të brendshëm Bruto shoqërohet me rritjen e deficitit në bilancin tregtar, duke parashikuar nivel të ulët eksportesh në krahasim me importet. Struktura e PBB-së është përkeqësuar, duke u zvogëluar pjesa që zenë industria dhe bujqësia. Mbajtja e nivelit të ulët të inflacionit në tërësi shoqërohet me rritje çmimesh në disa sektorë, duke thelluar varfërinë, duke dobësuar fuqinë blerëse dhe duke rritur koston e prodhimeve. Rritja ekonomike shoqërohet me shtim të numrit të të papunëve. Borxhi publik rritet dhe kursimet e popullsisë përdoren për të financuar këtë deficit, duke ulur pjesën që përdoret për të kredituar ekonominë private.

3. Projektbuxheti dëshmon për përkeqësim të administrimit dhe të arkëtimit të të ardhurave nga tatimet dhe taksat, për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit dhe të ekonomisë informale.

4. Shpenzimet buxhetore janë me rënie nga viti në vit, e cila sjell rënien e shpenzimeve të parashikuara për investime dhe për shërbime. Veç rënies në total të shpenzimeve, vihet re deformim i strukturës së tyre, duke pakësuar pjesën e shpenzimeve që shkon për investime, në favor të rritjes së shpenzimeve korrente. Është rritur pjesa e shpenzimeve që përdoren për sigurime shoqërore dhe asistim social, gjë që shoqërohet me rënien e investimeve publike në arsim, shëndetësi e kulturë.

5. Projektbuxheti nuk mbështet sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë si sektorë prioritarë, në të cilët vihet re rënie e investimeve.

6. Në projektbuxhet vihet re zvogëlim i granteve për pushtetin lokal dhe për shtresat në nevojë, veçanërisht për pensionistët.

Deputetët e opozitës i paraqitën Kuvendit disa amendamente për ndryshimin e projektbuxhetit të vitit 2005, të cilat sipas tyre, synojnë të zbusin mangësitë e konstatuara prej tyre në këtë projektligj. Synimi kryesor i këtyre amendamenteve ishte rritja e të

ardhurave të Buxhetit të Shtetit, të cilat shoqërohen me rritje të shpenzimeve buxhetore, veçanërisht të shpenzimeve për investime.

Gjatë shqyrtimit të amendamenteve të paraqitura nga opozita, deputetët e maxhorancës u shprehën kundër tyre, me argumentin që niveli i të ardhurave të parashikuara në projektbuxhet mbështetet në mundësitë e organeve tatimore për mbledhjen e tyre dhe ai nuk mund të rritet më tej, pasi kjo rritje e të ardhurave do të ishte e pabazuar dhe e porealizueshme dhe do të ndikonte në parashikimin më të lartë dhe fiktiv të shpenzimeve buxhetore, duke krijuar mundësi shpërdorimesh të shpenzimeve gjatë fushatës elektorale. Gjatë shqyrtimit të shifrave të projektbuxhetit Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit u ndal në mënyrë të vecantë në shpërndarjen e shpenzimeve sipas sektorëve të ekonomisë dhe në efektivitetin e përdorimit të tyre. Ai shqyrtoi propozimet e komisioneve të përhershme të Kuvendit për shtim shpenzimesh për institucionet e pavarura dhe për disa institucione të tjera, si dhe për disa diskutere. Komisioni i Ekonomisë i vlerësoi drejt këto kërkesa, por në pamundësi të gjetjes së burimeve financiare për plotësimin e tyre tej projektbuxhetit të parashikuar, mori në konsideratë disa prej tyre që i vlerësoi si të domosdoshme dhe në veçanti, nevojat për investime.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi disa ndryshime në projektbuxhetin e paraqitur, ndër të cilat më kryesoret janë:

1. Rritja e fondit të pensioneve nga 4 për qind që ishte parashikuar në projektin e Qeverisë, në 10 për qind, duke filluar nga 1 qershori i vitit 2005.

2. Rritja e fondit të pagave për të përballuar rritjen më të lartë se parashikimi të pagave në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë.

3. Përmirësimi i reformës së decentralizimit të pushtetit vendor, duke përfshirë në ligj tabelën e ndarjes së fondeve për investime në arsim, shëndetësi dhe për ndihmën ekonomike, si grant i kushtëzuar, si dhe duke përmirësuar tabelën e projektligjit që përcakton ndarjen e funksioneve midis pushtetit qendror dhe atij vendor.

4. Mbështetja më e madhe e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës në zonat urbane dhe rurale, sidomos për rikonstruksionin e ujësjellësave, të kanalizimeve, të rrugëve, asfaltimeve etj.

5. Reduktimi i kompetencës së rialokimeve buxhetore të Këshillit të Ministrave, për të rritur më tej kontrollin e Kuvendit në zbatimin e buxhetit etj.

Kuvendi e miratoi projektbuxhetin me shumicë votash, së bashku me ndryshimet e propozuara nga Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit në nenet e projektligjit dhe në tabelat shoqëruese të tij. Opozita votoi kundër projektligjit.

# KALENDAR I

## 3 JAVOR (31 janar-17 shkurt 2005) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

*E Hënë, datë 31 Janar 2005, ora 17.00*  
*-Seancë Plenare*

1. Miratimi i Kalendarit 3 javor të Punimeve të Kuvendit.
2. P/Vendim "Për caktimin e Përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Kuvendit".
3. P/Vendim "Për caktimin e sekretarëve dhe sekretariateve të Kuvendit"
4. Zgjedhja e Byrosë së Kuvendit.

**Data 31 janar 2005 deri 4 shkurt 2005 – Veprimtari në komisione**

**Projektligji "Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë"**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat (*paraqet mendimin në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin deri në datën 4 shkurt 2005*)

**Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.8770 datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë publike"**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare  
**Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr.9062 datë 8.5.2003 "Kodi i Familjes".**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096 date 21.3.1993 "Për kinematografinë"**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

**ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8025 date 9.11.1995 "Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese"**

Komisioni për Integrimin European (*për perputhshmërinë me legjislacionin e Bashkimit European paraqet mendimin brenda datës 4.2.2005 në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*)

**Projektligji "Për ratifikimin e marrveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Polonisë për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar".**

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

**Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito-centrale (MCC SPA) për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnje – Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmente rrugore, Lushnje – Fier dhe Fier - Vlorë"**

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë financiare për projektin e ndërtimit të linjës 400KV, Tiranë-Podgoricë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Kreditanstalt FUR WIDERAUSFBAU, Frankfurt AM MAIN (KFW), marrveshjes së garancisë ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt FUR WIDERAUSFBAU, Frankfurt AM MAIN (KFW), si dhe të marrveshjes së arbitrazhit ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Kreditanstalt FUR WIDERAUSFBAU, Frankfurt AM MAIN (KFW).**

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Projektligji "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"**

Diskutimi në parim (*Mbledhje e përbashkët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*)

**Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 9049 datë 1.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nënpunësve publikë"**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

*(Vijon në faqen 17)*



## KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 16)

**Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049 datë 1.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

**P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”**

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Shqyrtimi i propozimit për një anëtar të Komisionit të Letrave me Vlerë.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

**Seancë dëgjimore publike “Shqyrtimi Raportit të Komisionit të Shërbimit Civil” dhe përgatitja e projektrezolutës për vlerësimin e punës së këtij institucioni**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**E Hënë datë 7.2.2005 – Ora 17.00**

- Seancë plenare

**Pyetje dhe Interpelanca.**

**Raport i Komisionit të Shërbimit Civil.**

**E Enjte, datë 10.2.2004 - Ora 10.00**

- Seancë plenare

1. Diskutim për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri në 60 minuta)

2. Diskutimi në parim i projektligjeve:

- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë finaciare për projektin e ndërtimit të linjës 400KV, Tiranë-Podgoricë, ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Kreditanstalt FUR WIDERAUSFBAU, Frankfurt AM MAIN (KFW), marrëveshjes së garancisë ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe Kreditanstalt FUR WIDERAUSFBAU, Frankfurt AM MAIN (KFW), si dhe të marrëveshjes së arbitrazhit ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Kreditanstalt FUR WIDERAUSFBAU, Frankfurt AM MAIN (KFW).

- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes finaciare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës

së Shqipërisë dhe Mediocreditocentrale (MCC SPA) për financimin e programit për ndërtimin e segmentit rrugor Lushnje – Fier dhe mbikëqyrjen e punimeve për dy segmente rrugore, Lushnje – Fier dhe Fier - Vlorë”.

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8770 datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë publike”

- Shqyrtimi i propozimit për një anëtar të Komisionit të Letrave me Vlerë.

3. Ora 13.00 votimi i projektligjeve në parim, shqyrtimi dhe votimi nën për nën dhe në tërësi.

**Data 7 shkurt 2005 deri 11 shkurt 2005**

**Veprimtari në komisione**

**Projektligji “Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë”**

Diskutimi në parim në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

**Projektligji “Për ndihmën dhe përkrahjen shoqërore”**

Diskutimi nën për nën (Mbledhje e përbashket e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë)

**Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8749 datë 1.3.2001 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik”**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

**Projektligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruara në organe të rëndësishme të shtetit”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7973 datë 26.7.2005 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

**Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8685 datë 9.11. 2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera dhe nëntokë”.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat (paraqet mendimin për ndikimin në buxhet deri në 10.2.2004)

(Vijon në faqen 18)

# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 17)

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

## Projektligji “Akti i lirisë së shtypit”

Jep mendim për respektimin e të drejtave të njeriut  
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut deri në 10 shkurt 2005

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

## Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8025 datë 9.12.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

## Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
**Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë në çështjet civile”**

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

## P/Ligji “Për efikasitetin e energjisë”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut  
**P/Ligji “Për konfliktin e interesave”.**

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

## Shqyrtimi i plotësimit të kushteve ligjore për kandidim të kandidatëve për Avokatin e Popullit

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

## Seancë degjimore publike “Shqyrtimi i Raportit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit”

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

**E hënë datë 14.2.2005 – Ora 17.00**

- Seancë plenare

1. Pyetje dhe Interpelanca
2. Raportimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dhe votimi i p/vendimit për miratimin e këtij raporti.

**Koha e debatit:**

**Grupi Parlamentar PS**

**60 minuta**

**Grupi Parlamentar PD**

**30 minuta**

**Grupet e tjera parlamentare**

**15 minuta**

**E enjte, datë 17.2.2005 - Ora 10.00**

- Seancë plenare

**1. Diskutim për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri në 60 minuta)**

**2. Diskutimi në parim i projektligjeve:**

- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”

- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Polonisë për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar”

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096 datë 21.3.1993 “Për kinematografinë”

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7973 date 26.7.2005 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”

**3. Zgjedhja e Avokatit të Popullit.**

**4. Ora 12.00 votimi i projektligjeve në parim, shqyrtimi dhe votimi nën për nen dhe në tërësi.**

**Data 11 shkurt 2005 deri 16 shkurt 2005 –**

**Veprimtari në komisione**

**Projektligji “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (*vijon shqyrtimi nën për nen*)

**Projektligji “Për ndihmën dhe përkrahjen shoqërore”**

*Vijon shqyrtimi nën për nen (Mbledhje e përbashkët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë)*

**Projektligji “Akti i lirisë së shtypit”**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (*vijon diskutimi nën për nen*)

**Projektligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*vijon diskutimi nën për nen*)

**Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8607 datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

(*Vijon në faqen 19*)

# KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 18)

**Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij ujëmbledhës”**

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

**P/Ligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”.**

Komisioni përgjegjës: Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

**Seancë dëgjimore publike “Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve” dhe pregatitja e projektrezolutës për vlerësimin e punës së këtij institucioni.**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

## KOHA PËR ÇËSHTJET E PARASHIKUARA PER SHQYRTIM NË KALENDARIN E PUNIMEVE TË KUVENDIT

Nismëtari i projektligjit	15 minuta
Paraqitja e raportit të komisionit Relatori	10 minuta
Çdo deputet për diskutimin në parim	10 minuta
Çdo deputet për diskutimin nën për nën	5 minuta

## SHQYRTIMI RAPORTEVE TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË KUVEND

Paraqitja e raportit 60 minuta

Paraqitja e projektrezultës së Komisionit -

Në seancën plenare për shqyrtimin e raportit mund të mbahet debat në rast se kërkohet me shkrim një gje e tillë nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë. Koha e debatit përcaktohet paraprakisht nga Konferenca e Kryetarëve.

### KUJTESË

1. Amendamentet, si rregull, paraqiten në komisionin përgjegjës. Amendamentet mund të paraqiten në seancë plenare me kusht që të jenë rregjistruar 24

orë para kohës së fillimit të shqyrtimit të projektligjit.

2. Autori i amendamentit të rrëzuar në komisionin përgjegjës ka të drejtë ta paraqesë atë në seancë plenare për jo më shumë se 7 minuta.

3. Çdo deputet që dëshiron të diskutojë në seancë plenare duhet të jetë rregjistruar në sekretari para fillimit të seancës plenare.

## RAPORTET E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR SEANCËN PLENARE

**Raportet e komisioneve të përhershme për në seancë plenare duhet të përmbajnë:**

- Nevojën e ndërhyrjes normative në fushën e caktuar të marrëdhënies shoqërore.

- Analizën e përputhshmërisë së projektligjit me Kushtetutën.

- Raportin mes parimeve dhe formulimeve të sanksionuara në projektligj me atë të legjislacionit ekzistues.

- Efektet sociale, ekonomike dhe juridike të projektligjit. Vend i veçantë duhet t'i jepet çështjes së efekteve financiare që sjell projektligji dhe nëse ka rritje të shpenzimeve të buxhetit të shtetit si do të përballohen ato.

- Harmonizimin e projektligjit me legjislacionin në fuqi. Komisioni i Integritimit Europian paraqet analizën për harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Europian.

- Për marrëveshjet ndërkombëtare duhet të tregohet nevojshmëria e ratifikimit të marrëveshjes me ligj, vetzbatueshmëria e marrëveshjes dhe, nëse ajo s'është e tillë, kuadrin e akteve ligjore që duhet të preken me qëllim që marrëveshja të vihet në zbatim.

Konsiderat për elementet e gjuhës normative të përdorur në drejtim të formulimit të projektligjit, ndertimit të tij, formulimit të neneve, referencat, delegimin për nxjerrjen e akteve nënligjore, dispozitat tranzitore dhe e hyjes në fuqi.

### Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator  
Qendra e Studimeve Parlamentare/  
Centre for Parliamentary Studies  
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15  
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;  
[cps@albaniaonline.net](mailto:cps@albaniaonline.net);  
[www.ascdpd.org](http://www.ascdpd.org)